



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr. 06-23085 2022

Klinë, datë:

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur me datë 26. 05. 2022, në sallën e Kuvendit, nisur nga ora 10:00.

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi. Duke përshëndetë të gjithë të pranishmit: anëtarët e kuvendit, kryetarin e komunës dhe të tjerë, kryesuesi, z. Gashi në emër të të gjithëve i shprehu ngushëllime nënkryetares së Komunës, znj. Selmanaj për vdekjen e prindit. Kryesuesi theksoi se ka një kërkesë për dy komitete, komitetin për politikë dhe financa dhe komitetin për komunitetet se të martën kanë takim me DEMOS dhe se duhet konfirmuar pjesëmarrjen. Po ashtu dua të ju informoi se ka ardhur një kërkesë në adresë timen nga LVV dega në Klinë që kuvendi ta nxjerr një deklaratë në mbështetje të ministrisë për nxjerrjen e vendimit për pezullim të pëlqimeve – jo të lejeve për fabrikën e çimentos. Unë dua të kërkoj nga Kuvendi që të kujtohet se ky kuvend ka nxjerr vendim për këtë çështje dhe është deklaruar përmes vendimit të nxjerra dhe kurrësi deklarata e kërkuar nga LVV nuk mund ta ketë forcën e vendimit të marrur pikërisht nga Kuvendi. Ai vendim është në gjykatë tashme dhe po ashtu në seancat paraprake si kuvend kemi themeluar një komision hetimor për këtë çështje i cili komision është duke punuar sa kam informacion unë. Mendoj që ne si kuvend nuk mundemi me deklarata as të i mbështesim as të i kritikojmë vendimet e marrura nga niveli qendror. Gjithsesi unë e kam obligim që të ju informoj çdo gjë që vjen në adresën e kryesuesit të Kuvendit.

z. Esat Raci: Përshëndetje të gjithëve. Sa i përket kërkesës së LVV unë kam dashur që ta bëjë pyetje në pikën e rendit të ditës se a është informuar komuna e Klinës për vendimin e marrur nga ministria e linjës për pezullimin e lejeve për fabrikë të çimentos.

Znj. Valmira Krasniqi: Përshëndetje të gjithëve. Ne në bazë të ligjit për vetëqeverisje lokale kërkojmë që të nxjerrët në votim kjo deklaratë. Pse mos të deklarohejmë edhe ne dhe të tregojë që jemi kundër pëlqimeve të dhëna. Kryetari i Komunës me datën 13 maj ka deklaruar se në lidhje me lejen e dhënë për ndërtim paska dalë para aktit të kryer në kuptimin se ministria në fjalë i ka pasur të gjitha fajet. Prandaj unë kërkoj që ne si asamblistë të ja dëshmojmë qytetarëve të Klinës se jemi kundër kësaj fabrike.

z. Fadil Gashi, kryesues: Po më vjen keq por ju nuk keni qenë në atë mandat kur Kuvendi ka nxjerr vendim dhe ju kemi treguar qytetarëve të Klinës se si kuvend jemi kundër ndërtimit të kësaj fabrike. Nuk mundemi që sa herë të ndërrohen anëtarët e kuvendit të nxjerrim nga një deklaratë të re me përmbajtje të vjetër. Ne jemi duke e mbrojtur votën tonë, votën e kuvendit në Gjykatë. Ju lutem që ta tërhiqni deklaratën e propozuar sepse kjo deklaratë nuk e ka peshën e vendimit të marrur nga Kuvendi pikërisht për mbështetjen e qytetarëve kundër fabrikës. 27 anëtarë të kuvendit kanë votuar pro, pa asnjë votë

kundër apo abstenim. Kjo është një deklaratë për institucione qendrore jo për ne. E unë mendoj që vendimet që marrin institucionet qendrore ne nuk mund të i imponojmë, as të i vlerësojmë me deklaratë e as të i kundërshtojmë me deklarata.

Znj. Valmira Krasniqi: Unë mendoj që ne duhet të ja dëshmojmë qytetarëve. Nëse nuk mund ta ketë përkrahjen kjo deklaratë të paketën a kemi mundësi që ta lexojmë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Unë jam i obliguar që ta nxjerr në votim deklaratën tuaj nëse ju nuk e tërhiqni.

z. Arben Limanaj: Përshëndetje. Ne si asamblistë në mandatin kur kemi marrur vendimin për të anuluar pëlqimin jemi deklaruar me vota. Tani një shkresë e tillë e ardhur nga një grup kuvendar pa koordinim paraprak me grupet e tjera nuk mendoj që do të duhej. Nuk do ta mbështesim këtë deklaratë pasi që e shohim të pa arsyeshme.

z. Valmir Bacaj: Përshëndetje. Ne ashtu siç e tha edhe kryesuesi, si kuvend kemi marrur vendim dy herë radhazi për anulimin e pëlqimeve. Po ashtu kemi krijuar një komision për hetimin e procedurave të dhënies së lejeve. Dhe përfundimisht nuk mund ta mbështesim një deklaratë pa e ditë përmbajtjen e sajë.

z. Zafer Gashi: Përshëndetje për të gjithë. Ngushëllime znj. Selmanaj për vdekjen e prindit. Ka të drejt Arben Limanaj kur thotë se nuk jemi konsultuar paraprakisht me grupet kuvendare për këtë deklaratë. Rrethanat ishin të tilla dhe nuk arritëm që të konsultohemi paraprakisht. Propozoj që të marrim një pauzë prej 15 minutave dhe ta përpilojmë tekstin së bashku me shefat e grupeve kuvendare dhe të dalim së bashku me një deklaratë në mbështetje të qytetarëve kundër ndërtimit të fabrikës në fjalë dhe në mbështetje gjithashtu të atyre dy vendimeve të marrura nga kuvendi në mandatin e kaluar. Nuk ka ndonjë prapavijë tjetër kjo deklaratë. Kryesuesi mund ta lexoj, ta nxjerr në votim dhe të vazhdojmë tutje.

Pas një debati të shkurtër në vazhdim, ku diskutuan kryesuesi i kuvendit, Zafer Gashi, Valmir Bacaj, Esat Raci, Kushtrim Haliti, etj. Z. Raci dhe Bacaj deklaratën e tillë e konsideruan si deklaratë populiste dhe puro politike. Z. Esat Raci kërkoj që mos ta na qesin në pozita të tilla të pa lakmueshme herë të tjera. Deklaratën në fjalë e lexoj anëtarja e kuvendit nga LVV dhe kryesuesi e vuri në votim.

Me 3 vota për, 15 kundër dhe asnjë abstenim, NUK U MIRATUA

Kryesuesi e vuri në votim rendin e ditës dhe me 27 vota për u miratua

Pika 1 e Rendit të ditës: 27 anëtarë të kuvendit janë prezent

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Në këtë pikë kryesuesi i kuvendit kishte konstatuar se është bërë një gabim. Në vend të zona kadastrale Dresnik është shkruar zona kadastrale Gremnik.

z. Zafer Gashi: Dua të bëjë një sqarim që mos të i mbes borgj zotërisë që e mbanë procesverbalin. Jemi shumë të kënaqur me atë që shkruhet në proces. Herën e kaluar kemi abstenuar në votimin e procesverbalit jo sepse kemi pasur vërejtje në procesverbal por për shkaqe të tjera.

Me 27 vota për aprovohet procesverbali, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika 3 e Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF-së

Me 26 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA në tërësi rekomandimet e KPF-së.

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për vendosjen në diskutim publik të draft strategjisë për zhvillim ekonomik lokal 2022-2027 për Komunën e Klinës.

z. Ajet Sejdiu, UD i drejtorit të FEZH: Përshëndetje. Siç jemi të njoftuar strategjisë së më parshme i ka skaduar afati prandaj kemi nisur hartimin e strategjisë së re. Kemi kontraktuar kompaninë që do të bëjë zhvillimin e punimeve. Kërkojmë që të gjithë akterët që kanë mundësi të ndihmojnë mund të kyçen. Gjithashtu ky draft do të i nënshtrohet diskutimit publik.

Kryesuesi theksoi se sot të merret vendim vetëm që të lëshohet në diskutim publik.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje të gjithëve. Në këtë strategji është mirë të parashihet hapja e kanaleve dhe ujitja e çdo pëllëmbë toke. Nëse ujitjen tokat prodhimet do të katërfishohen gjithsesi.

z. Zafer Gashi: E kam lexuar këtë strategji zhvillimore. Mund të them se komuna ka punuare dhe ka angazhuar kompani konsulentë por ka diçka që është mungesë dhe shpresoj që të plotësohet. Ajo që më pëlqeu është dizajni i bërë por përmbajtja është më rëndësi. Nuk dyshoj që ka vlera. Këtë strategji askund nuk e shoh që ka me u ndërtuar fabrika e çimentos. Te furnizimi me ujë, vërtetohet edhe nga strategjia se rezultatet e pritura nuk ishin të kënaqura. Tek ujërat e zeza përmendet projekti në fshatin Volljak- punimet janë kryer me ritëm shumë të ngadalshëm dhe projekti nuk ka arritur të jetë plotësisht në funksion. Etj. Tek analiza SWOT, në faqe 65 parashihet niveli i rrezikut. Lexoni përmendet rënia e nivelit të arsimit nga viti në vit. Pra, nuk duhet ta kemi prioritet vetëm infrastrukturën ndërtimore në arsim por politikat e punësimit dhe ngritjes së nivelit të mësimdhënies. Ruajtja e ambientit, thuhet – rishikimi i planit menaxhues të pyjeve në nivel komunal. Çka do të thotë kjo? Pjesa më e madhe e pyetjeve që ju ka dhënë në shfrytëzim për shumë vjet janë dëmtuar. Etj. Askund s' ka projekt ku gjinia femërore do të jetë prioritet për ndërmarrjet e mesme. Nxitja e investimeve direkt të huaja dhe tërheqja e 6 milion eurove deri në vitin 2027. Ne do të jemi përkrahës të çdo projekti të investimeve të huaja gjithsesi por qysh është vepruar deri tani. Të shkohet në Zvicër dy herë dhe në fund të largohet komplet ai investitori që ka dashur të investoj në menaxhimin e mbeturinave.

z. Gashi kishte disa vërejtje të tjera dhe propozime në lidhje me strategjinë zhvillimore për ta përmbyllur me fjalët: " Duhet të kemi kujdes që të rritet buxheti komunal në mënyrë që të mbulohen këto planifikime."

Kryesuesi edhe një herë e theksoi se sot do të merret vendim vetëm që të nxirret në shqyrtim publik ky draft dokument dhe se çdo njeri ka me pas mundësi që të bëjë propozime dhe vërejtje në vazhdim të shqyrtimit të tij.

z. Tunë Dedaj: Unë e përkrahu këtë strategji. Nuk po mundem që të pajtohem me diskutuesin e më parshëm sepse vazhdimisht po përmendet fabrika e cementit dhe ruajtja e ambientit. Unë para dy ditëve e kam vizituar fabrikën e çimentos në Shqipëri dhe nuk kam pa asnjë lloj pluhuri aty. Ata janë gati me na pritë në një vizitë që të shohim vet se si funksionon. Ne nuk jemi të sigurt se a ka me pas ndotje ajo fabrike apo jo. Nëse do të kishte ndotje unë i pari jam kundër.

z. Kolë Prenaj: Përshëndetje. Me të vërtetë ka rëndësi shumë që të bëhet një strategji e mirë e zhvillimit. Ju sugjeroj që të bashkëpunohet afër me akterë të ndryshëm. Duhet të ketë një koncept, një vizion se si do të zhvillohet komuna e Klinës në 5 vitet e ardhshme. Kam qenë pjesë e një strategjie të

zhvillimit të komunës së Klinës në vitin 2012 , projekt i financuar nga BE. Është një material rreth 200 faqesh dhe nuk e diji se a e ka shfletuar kush atë material, sepse është shumë i vlefshëm. Ju lutem që të epen mendime dhe ide të reja që të ndihmohet ekipi që punon në këtë strategji. Unë jam në dispozicion nëse ju duhet ndihma e ime.

z. Valmir Bacaj: Ashtu siç u tha më herët , ky është një dokument i një kompanie kontraktuese nga Komuna e Klinës. Dua të bëjë një reagim ndaj parafolësit z. Gashi nga LVV kur e përmendi faqen 65 dhe theksoi se analiza SWOT ka konstatuar se ka rënie të nivelit të arsimit. Analiza SWOT e ka parashikuar si rrezik e jo që ka konstatuar , prandaj nuk është mirë të dezinformohet opinioni publik. Analizat e tilla bëhen që të parandalohen rreziqet e tilla.

z. Zafer Gashi: Kur është e shkruar edhe lexohet ashtu qysh është e shkruar. Rreziqet në faqen 65 është e shkruar me të kuqe. E parafundit shkruan: Rënie e nivelit të arsimit. Nëse është kjo strategji për komunën e Klinës atëherë shumë pastër shkruan.

z. Fadil Gashi, kryesues: Kjo strategji behët për zhvillimin e ardhshëm prandaj ato që lexohen aty mirë është të konsiderohen si parashikime për të ardhmen e jo konstatime.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Përshëndetje të gjithëve. Mua më vjen keq që më duhet me dalë sepse jam duke e pritur ministrin e bujqësisë në takim. Në lidhje me analizën SWOT është mirë të lexohet dhe mësohet kjo lloj analize. Ne jemi duke u munduar që të përpilojmë një dokument politik që do të jetë në shërbim të qytetarëve. Ky lloj dokumenti si kjo strategji është një planifikim që përmes mekanizmave të tjerë do të mundohemi që ta implementojmë.

z. Zafer Gashi: Unë e dhashë edhe definicionin se çfarë është analiza SWOT.

z. Fadil Gashi, kryesues: Çdo dokument tjetër financiar këtë strategji do ta ketë referencë. Edhe korniza afatmesme buxheti edhe buxheti fiskal prandaj të kontribuojmë që të pasurohet ky dokument.

z. Esat Raci: Meqenëse është strategji zhvillimore, ne si grup kuvendar e përkrahim që të vendose në diskutim publik . Konsiderojmë që kjo strategji zhvillimore është në të mirë të qytetarëve dhe nuk është e një partie politike.

z. Arben Limanaj: Kur të vjen për shqyrtim dhe miratim ne si grup do të japim kontributin tonë. Sot është vetëm që të lëshohet në diskutim publik dhe s` ka qenë asnjëherë praktikë që të diskutohet përmbajtja në këtë fazë.

z. Kolë Prenaj: Propozoi që të formohet një grup punues e të punohet disa ditë më shumë në detaje në këtë strategji. Kjo praktikë ka ekzistuar para disa viteve.

z. Fadil Gashi, kryesues: Po jam absolutisht i pajtimit që të formohet një grup i tillë punues.

Kryesuesi e vuri në votim lëshuarjen në diskutim publik të strategjisë zhvillimore në fjalë dhe me 26 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 5 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për zëvendësim të anëtarit të KKSB

Kryesuesi theksoi se në këtë këshill duhet që të ndërrohet z. Tunë Dedaj nga KKSB me z. Hazir Tigani pasi që në këtë këshill Tunë Dedaj ka ardhur si kryetar i këshillit të prindërve dhe se tani është zgjedhur

kryetari i ri z. Hazir Tigani. Kemi kërkesën për ndryshim të vendimit. Pra, ky kuvend duhet që ta ndryshoj vendimin e vet.

z. Tunë Dedaj: Po e vërtetë. Edhe atëherë kur kam ardhur unë anëtarë i KKSBB para 8 viteve është tërheq kryetari i më parshëm dhe kam ardhur unë. Edhe tani ka ardhur kryetari i ri i këshillit të prindërve dhe unë do të tërhiqem.

Kryesuesi në emër të kuvendit e ka falënderuar për kontributin e tij shumë vjeçar dhe e vuri në votim ndryshimin. Me 26 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim u zëvendësua z. Tunë Dedaj me z. Hazir Tigani në KKSBB.

Pika 6 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i menaxhimit të qeneve endacak në Komunën e Klinës.

Kryesuesi theksoi se është marrë si kërkesë në KPF dhe nuk është arritur që t diskutohet mirë prandaj është propozuar që të vije në kuvend .

z. Shëndrit Gashi, zyrtar në drejtorinë e SHP dhe menaxher i kontratës për trajtimin e qeneve endacak: Përshëndetje për të gjithë. Po ju jap disa të dhëna për këtë kontratë. Kontrata është e lidhur në prill të vitit 2022. Shuma e kontratës është 20 mijë euro. OE që vepron në këtë kontratë është ambulanta veterinare nga Rigjeva me pronar Driton Morina.

z. Gashi në vazhdim dha informacione si si vepron operatori në lidhje me trajtimin e qeneve endacak, raportet zyrtare mes OE dhe Drejtorisë, menaxherit respektivisht. Ai theksoi gjithashtu se Komuna e Klinës është Komuna e vetme në Kosovë që ka një kontratë me një OE për trajtimin e qeneve endacak dhe se puna ka shkuar mirë duke mbetur edhe gjithsejtë 50 ose 60 qenë për tu trajtuar në total.

z. Tunë Dedaj: Edhe pse e diji që Komuna nuk ka mundësi materiale që të bëjë grumbullimin dhe menaxhimin e qeneve endacak, kërkoj që në nivel të shtetit të gjendet një zgjidhje e përhershme. Kjo që bënë Komuna e Klinës është e mirë por nuk është se po bëjmë zgjidhje me këtë kontratë, nuk i shpëtojmë fëmijët tanë nga qentë përmes kësaj kontrate. Sepse qentë merren trajtohen dhe prap lëshohen të lirë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Nuk e diji nëse e keni lexuar e parë se në Komunë e Pejës një qytetar e ka paditur komunën [për kafshimin që i ka bërë një qen endacak dhe ka fituar gjyqin ndaj Komunës duke përfituar një shumë goxha të madhe. Dua të them se kjo është përgjegjësi e Komunës dhe nuk duhet të përjashtohet asnjë mundësi tjetër edhe të shtohet buxheti dhe kjo çështje të zgjidhet mirë e përgjithmonë . Është bërë jetë e padurueshme , rrezikun e kemi në derë për fëmijët tanë, pleqtë dhe të dashurit tanë , nga këta qenë endacak. Nëse Ekzekutivit i duhet vendimi i Kuvendit , ne jemi gati ta përkrahim çdo projekt , çdo iniciativë e alternativë që të bëhet zgjidhje.

z. Kushtrim Haliti: Kam vetëm një kërkesë për Shëndritin. Ata që po e bëjnë trajtimin e qeneve mos të na i sjellin dhe lënë të lirë në Gjurgjevik të Madh sepse ka shumë mungesa nxënësish që shkaku i tyre nuk guxojnë me ardh në shkollë. Të gjithë po kërkojnë me jetu në qytet, le ti lëshojnë në qytet.

z. Arben Limanaj: Nuk e diji a është paraparë në këtë projekt që të ketë strehimore për këta qenë sepse trajtim tjetër nuk mendoj që do të ketë sukses.

z. Shëndrit Gashi: Operatori e ka në kontratë që qenin e kapur pasi të trajtoj duhet ta lej të lirë aty ku është marrë. Shuma e kontratës është minimale vetëm 20 mijë euro prandaj nuk është paraparë

strehimore. Për strehimore duhet të kemi të paktën 500 mijë euro. Gjithashtu për eliminimin e qeneve duhet të marrim leje të veçantë, leje për strehimin e tyre etj.

z. Fadil Gashi, Kryesues: Mendoj që është e pa drejtë që të eliminohet një qenë por shtrohet pyetja : qeni apo fëmija jonë. Sidoqoftë duhet angazhuar dhe konsultuar edhe faktorë të tjerë si policia, shoqata e gjuetarëve, Komuna , OJQ etj. dhe të bëhet një zgjidhje. Mund të gjenden edhe donacione që të rriten kapacitete materiale.

z. Binak Sylaj, drejtor i SHP: Përshëndetje të gjithëve. E tha edhe menaxheri i kontratës. Dhe në vitet e kaluara kemi kërkuar në vazhdimësi që të trajtohen qentë endacak. Shihet ë mënyra se si po trajtohen qentë endacak nuk është efikase pasi që po kemi probleme edhe me komunat e tjera, në kuptimin që qentë endacak po drejtohen në komunën tonë edhe nga komunat e tjera. Mendoj që zyrtari i drejtorisë së SHP , menaxheri i kontratës të shfrytëzoj autoritetin e vet dhe të drejtorisë dhe të kërkoj nga niveli qendror të merren hapa konkret në këtë drejtim që të bëhet një zgjidhje tjetër e përhershme dhe efikase.

Pika 7 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe Përgjigje.

z. Esat Raci: Pyetja e parë është ajo që e thash në fillim të kësaj seance, është për drejtorin e urbanizimit. Ndërsa pyetja e dytë ishte për kryetarin por pasi që ai shkoj po i drejtohem Ajët Sejdiut- A i ka plotësuar Komuna e Klinës kriteret e performancës për përfitimin e granteve financiare? Nëse jo , pse nuk i ka plotësuar?

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit: Përshëndetje të gjithëve. Do të ju njoftoj në pika të shkurtra rreth procedurave pas marrjes së vendimit nga ministria përkatëse për pezullim të pëlqimit që e ka dhënë vet paraprakisht. Sa i përket pezullimit të vendimit nr. 35 të vitit 2021 i datës 22. 03. 2021 për pëlqimin mjedisor për fabrikën e çimentos nga Ministria e planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës, ne si institucione komunale e në veçanti drejtoria e urbanizimit kemi pranuar zyrtarisht vendimin e ministrisë me datë 20. 05. 2022. Pas kësaj dhe pas konsultimeve ne me datë 24. 05. 2022 ju kemi drejtuar me një shkresë zyrës ligjore në kuadër të komunës dhe kemi kërkuar që të na jep një mendim profesional për këtë çështje dhe të na sugjeroj hapat konkret. Për veprimet e mëtejshme do të ju informojmë me kohë. Nëse më lejohet që të i përgjigjem Zafer Gashit në lidhje me impiantin që është menaxhuar nga Komuna e Klinës. Kush të dojë mund të shkoj të shikoj dhe bëjë analizë dhe do ta shoh që nuk qëndron ajo që thotë zotëria.

z. Binak Sylaj, drejtor i SHP: Me sa jemi të informuar Klina ka qenë përfituese e grantit. Jemi eliminuar por ju kemi drejtuar gjykatës me një ankesë. Jemi duke pritur për vendimin e gjykatës. Ata na kanë penalizuar shkak i dy vendimeve që ne i kemi marr në këtë kuvend pas rishqyrtimit por nuk qëndron ai fakt i përdorur prej tyre.

z. Zafer Gashi: Ju kërkoj që të jeni të qetë kur diskutoni zoti drejtor i urbanizimit. Unë do të ju sjell video dhe foto në seancën tjetër nga ai impiant. Kam një pyetje për drejtorin e arsimit: I kam disa dokumente që për neve janë shqetësuese sepse ka të bëjë me shkelje të ligjit. Nënkrjetarja e kuvendit është prezent dhe ka qenë e involvuar drejt për drejt në këtë rast. Unë e kam bërë një kërkesë me datë 04. 03. 2022 në drejtorin e arsimit për marrjen e listës me emrat e mësimitdhënësve që japin mësim nga janari i 2021 deri me 15 shkurt 2022. Kam marrë përgjigje para 9 –të ditëve. Një përgjigje të shkurtër dhe me tregon kush ka qenë të punësuar dhe jep dy emra të ri. Shqetësuese është se këta vazhdojnë të bëjnë shkelje të

vendimit të inspektoratit të arsimit të datës 21. 11. 2021 në të cilin vendim janë përmendur emrat e personave që nuk janë të kualifikuar për mësimdhënie. Dy nga këta janë në listën e personelit të shkollës së mesme profesionale " Fehmi Agani" , Ju lutem që kjo të përmirësohet sepse do të keni sanksione nga inspektorati. (Ndërhynë kryesuesi duke kërkuar që të bëhet pyetja) Më tregoni si mund të japin mësim këta dy persona që nuk janë të kualifikuar?

Znj. Marqe Selmanaj, nënkryetare e Komunës: Përhëndetje të gjithëve. Zotëri i nderuar , këtu në këtë kuvend je përfaqësues i popullit por je duke kaluar në krejt personale. Do të duhej që të të përgjigjem njëjtë por unë dua të kursehem. Për informim, sa i përket rastit në fjalë unë nuk jam pjesë e paneleve më. Përndryshe në atë kohë kam qenë një paneliste që jam munduar ta kryej punën në mënyrën më të drejt të mundshme. Rasti që e diskutove tani është në shqyrtim e sipër sa e diji unë. Nuk mendoj që duhet të ndërpriten procedurat tani pasi që është në përfundim viti shkollor. Jam shumë e sigurt se zyra rajonale dhe drejtorja e arsimit kanë bashkëpunim dhe do ta japin përgjigjen e duhur e në kohën e duhur. Më vjen keq që nuk është drejtori këtu të na jep të dhëna më të sakta se sa unë por interesimi i juaj për arsimin në komune, të përgëzoj që e përcjell.

z. Zafer Gashi: ju lutem nuk thash askund që penalistët janë të pa kualifikuar. Ne duhet të respektojmë hierarkinë institucionale. Ju duhet të respektoni vendimin e inspektoratit të arsimit.

Znj. Marqe Selmanaj, nënkryetare: Zotëri unë ta dhashë përgjigjen. Përgjigje më të mirë do të ta jap drejtori i arsimit.

z. Kushtrim Haliti: Mua po më duket që këtu s' ka radhë për pyetje e përgjigje. Dikujt po i epët shumë hapësirë. Po ashtu po mungojnë drejtorët në këtë pikë të rendit të ditës duke na e bërë të pamundur pyetjet për ta.

z. Fadil Gashi, kryesuesi: Për të paren ke plotësisht të drejt. Jam duke e tejkaluar kohen në dispozicion për pyetjet e anëtarëve të kuvendit. Nuk do ta përsëris më, pyetja dhe përgjigja nuk është debat as analizë. Ju duhet të bëni pyetje dhe drejtorët ju përgjigjen, kaq. Ndërsa sa i përket mungesës së drejtorëve, të jeni të sigurt se sikurse ju që merrni materialin për seancë edhe atyre ju shkon i njëjti dhe janë të informuar mirë.

z. Tunë Dedaj: Kryesues unë kam një kërkesë për ju. Duke e marr parasysh që bujqit tanë gjendjen e tokave e kanë shumë keq. Nuk i kanë rregulluar shitblerjen, ndërrimet, trashëgimitë e tokave. Ju kërkoj që personalisht të angazhoheni bashkë me drejtorinë e kadastrit dhe të rregullohet.

z. Binak Sylaj, drejtor i SHP: Pajtohem me vërejtjen tuaj Kushtrim. Të informoj që dy nga drejtorët janë në një mbledhje në asociacionin e komunave, drejtoresha e kulturës nuk është në këtë mbledhje sepse është e angazhuar rreth festivalit ndërsa drejtori i bujqësisë është në takim me kryetarin dhe ministrin e bujqësisë.

z. Arben Limanaj: Dua ta shprehë një shqetësim të disa mësimdhënësve që kanë kandiduar për asamble në kohë zgjidhje. Këta asamblist kanë bërë një kërkesë për kompensim por përgjigja nuk merret shpejt dhe lindin polemika e shqetësime. Kujtoj që shqetësimi i tyre buron ngase ekzekutivi edhe pse kanë kandiduar janë paguar ndërsa ata jo. Dikush duhet të jap përgjigje pse arsimtarët janë të detyruar ta pezullojnë punën e tyre dhe të mos paguhen. Nëse nuk mund të përgjigjeni në këtë seancë, pres përgjigjen në seancën tjetër.

z. Valmir Bacaj: Neve në politikë e financa na ka ardhur kjo kërkesë. Ligji e përcakton saktë këtë çështje. Automatikisht hiqen nga lista e pagave të gjithë arsimtarët që kandidojnë në zgjedhje.

Znj. Lirie Gashi: Përshëndetje. Kam një kërkesë nga banorët e fshatit Dollc. Këtë kërkesë e kanë adresuar në KPF, dhe tek ju i nderuar kryesues kanë kërkuar që të ju mundësohet udhëtimi i nxënësve pa pagesë ose mundësisht 80% shpenzime të hequra. Unë si anëtare e kuvendit kërkoj që të gjithë nxënësve të komunës e Klinës të ju mundësohet udhëtimi pa pagesë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Për këtë të fundit e kemi pasur një debat. Ne kemi formuar një komision për vlerësimin e transportit të nxënësve. Ai komision është mirë që ta kryej punën e vet. Po jua lexoj kush është në këtë komision: Luigj Ademi, Kushtrim Haliti, Arlinda Selitaj, Blerina Gashi dhe Lirie Gashi. Ky komision sipas pikës 1. Të vendimit: Do të bëjë evidentimin e rasteve kur nevojitet sigurimi i transportit të nxënësve duke bashkëpunuar me drejtorinë e arsimit dhe duke u bazuar në ligjin për këtë çështje. Kam edhe një kërkesë tjetër nga komisioni hetimor për fabrikën e çimentos: Ata kërkojnë që kuvendi i komunës të caktohet stafi mbështetës për mbajtjen e procesverbalit. Përveç juve le ta dëgjojë edhe komisioni. Mandati për hetim është i juaji. Ju jeni votuar për të hetuar prandaj procesmbajtësin caktojeni ju nga radhët e juaja. Është eskuzivitet i juaji se qysh doni me punuar dhe vepruar. Në fund e bëni raportin final.

Në fund kryesuesi falënderoj të gjithë anëtarët e kuvendit dhe të pranishmit në këtë mbledhje të kuvendit. falënderoj për kontributin e dhënë në debate etj. Ai shpalli të mbyllura punimet e kësaj seance.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesuesi:

Fadil Gashi

